

PASQYRË NGA HISTORIKU I ARSIMIT TË MESËM SHQIP - GJIMNAZI I KUMANOVËS

Minir ADEMI¹

^{1*} *Department of History, Faculty of Philosophy, University of Tetova*

^{*} *Corresponding author e-mail: minir.ademi@unite.edu.mk*

Shteti I Maqedonisë së sotme të Veriut, zë fillqë me deklaratën e themelimit të Komitetit Antifashist Çlirimtar Kombëtar Maqedonas (KAÇKM). Arsिमimi ishte një nga prioritetet e këtij shteti të ri, pjesë e federates Jugosllave, andaj në pikën e 11 këtë të kësaj deklarate thuhej: “Qeveria Popullore duhet të mënjanoj analfabetizmin dhe të ngritë kulturën popullore si dhe të siguron arsimin pa pagesë”. Me këtë, krahas popullit maqedonas, të drejtën e arsimimit në gjuhën amtare e kishin të garantuar edhe nacionalitetet tjera që jetonin në Maqedoni, si: shqiptarët, turqit, serbët, vllahët etj.

Bashkësia e Arsimit Popullor me të shpejtë (nga 2 derimë 5 shtator 1944) solli vendimin për arsimin fillor dhe të mesëmi cili rregullohej me ligj të posaçëm dhe në nenin i parashihej që arsimi fillor të zgjasë 7 vite, ndërsa në nenin 2 parshihej që arsimi i mesëm të zgjasë 5 vite. Arsimi i mesëm kishte rëndësi jetike për qytetarët e Kumanovës, mirëpo duke i pasur parasysh kushtet e rënda pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, mësimi në gjimnazin “Goce Dellçev” të Kumanovës në gjysëmvetorin e pare të vitit shkollor 1944/45, nuk ishte realizuar. Presidiumi KAÇKM-së në bazë të një shkresë të datës 1 dhjetor 1944, kërkoi që Bllagoj Georgiovski i lindur në qytetin e Kriva Pallankës, të lirohet nga detyra e Brigadës maqedonase që ndodhej në qytetin Gorna Xhuma dhe me vendim të posaçëm ai emërohet drejtor i gjimnazit “Goce Dellçev” të Kumanovës.

Drejtori mori detyrën me datën 23.12.1945 dhe ditën e nesërme me shkresë njoftoi të gjitha organet e vendit se gjimnazi në Kumanovë do të filloj me punë më 1 shkurt 1945.²⁷⁶ Vendi ku do të zhvillohej mësimi i këtij gjimnazi ishte shkolla e sotme fillore “Braça Milladinovci”, e cila atë here quhej „Kliment Ohridski”. Në bazë të dokumenteve të Arkivit Shtetëror të Republikës së Maqedonisë- Sektori në Kumanovë, Gjimnazi i Kumanovës e videntohet nga 1 shkurti 1945.²⁷⁷ Në fillim në gjimnazin e Kumanovës ndiqnin mësimin edhe nxënës nga qytetet e tjera të Maqedonisë si p.sh. nga Kriva Pallanka, Kratova, e Sveti Nikolla.²⁷⁸

²⁷⁶ Дане Цеков, Куманово и Козјачијата во Ослободителната Војна (1941-1945), Графотекс-Куманово стр. 844.

²⁷⁷ Тајјана Арсовска, Гимназија „Гоце Делчев” 50 години наставана македонски јазик, Графотекс-Куманово, 1995, стр. 13.

²⁷⁸ Стојко Николовски-Стојановиќ, Школството во Куманово и Кумановско (1805-2000), Куманово, 2001, стр. 619.

Në gjimnazin „GoceDellçev” të Kumanovës poashtu mësimin e ndiqnin edhe nxënës të nacionaliteteve tjera që jetonin Brenda Maqedonisë, përfshirë këtu shqiptarët të cilët ishin të detyruar të mësonin në gjuhën maqedonase sepse nuk kishte të formuara paralele me mësim në gjuhën shqipe. Edhe pse vendi ende nuk ishte çliruar plotësisht, përsëri bëhej për përgatitjen dhe përzgjedhjen e kuadrit arsimor i cili në fillim mungonte. Mirëpo pas shumë përpjekjeve më datën 26.01.1945, Bashkësia e qytetit të Kumanovës e dërgon listën e kuadrit arsimor në Bashkësinë Popullore të Arsimit në Shkup të cilët e njoftojnë se ata do ta dërgojnë listën me emrat e 13 mësuesve të cilët do të angazhohen si kuadër arsimor pranë gjimnazit „GoceDellçev” në Kumanovë.

Në bazë të evidences nga librat amë pranë gjimnazit „GoceDellçev,, të Kumanovës në vitin shkollor 1944/45, mësimin e zhvilluan gjithsejt 337 nxënës të shpërndarë në 11 paralele, edhe atë shtatë paralele me mësim të mesëm dhe katër paralele me mësim fillor të cilat në atë kohë njiheshin si Gjimnazi i Ulët. Mirëpo, pas çlirimit përfundimtar të vendit, çështja e arsimit filloi të përmissohet dhe interesimi për arsimin fillordhe të mesëm vazhdimisht rritej. Më 18.02.1954 nga Këshilli Sindikalist i vendit të Kumanovës u themelua Universiteti i Punëtorëve “ProfesorMijallkoviç” në Kumanovë, i cili llogaritej në mesin e shkollave më të sukseshme të mësuesisë në Maqedoni.

Nga viti shkollor 1956/57, pranë gjimnazit „GoceDellçev” të Kumanovës kishin filluar edhe paralele te Shkollës së Mesme Ekonomike si organe të veçanta. Në vitin shkollor 1961/62, në analet e historis shënohet fillimi i paraleles së parë të mësuesisë me mësim në gjuhën shqipe në kuadër të Universitetit të Puntorëve “Profesor Mijallkoviç” në Kumanovë. Në bazë të librit amë të shkollës, në vitin shkollor 1961/62, për here të parë formohet paralelja pedagogjike e evidentuar si Kl-I-b-17, ku ishin regjistruar 46 nxënës shqiptarë prej të cilëve 43 meshkuj dhe 3 femra, me kujdestarin e klasës, profesorin e gjuhës shqipe Shaip Saliun.

Kjo paralele e normales me mësim në gjuhën shqipe zgjati vetëm katër vite dhe në vitin shkollor 1964/65, dolën gjenerata e parë e maturantëve me gjithsejt 21 nxënës nga të cilët 19 meshkuj e 2f emra, prej të cilëve e mbaruan me sukses vetëm 19 nxënës.²⁷⁹ Me ndërprerjen e paralelës pedagogjike apo të mësuesisë, u hap paralelja e parë me mësim në gjuhën shqipe në gjimnazin „GoceDellçev” të Kumanovës, në vitin shkollor 1964/65. Sipas evidences pedagogjike në këtë vit shkollor në këtë gjimnaz konkursi u hap për 9 paralele nga të cilët 8 paralele ishin paraparë me mësim në gjuhën maqedonase, ndërsa një paralele me mësim në gjuhën shqipe.

Golgota e shqiptarëve për të mësuar edhe nxënësit shqiptarë në gjuhën e tyre amtare u realizua pas 15 viteve të ekzistimit të gjimnazit të Kumanovës. Në paralelën e parë me mësim në gjuhën shqipe u regjistruan gjithsejt 41 nxënës. Në këtë paralele mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe në këto lëndë: Gjuhë dhe letërsi shqipe (ligjerues prof. Shaip Saliu), Gjuhë frënge (ligjerues prof. Ahmet Hajdari) dhe lëndën e histories (ligjerues prof. Faik Rushiti). Vazhdimi i procesit të mesëm arsimor në Kumanovë zhvillohej me shumë vështirësi duke hasë në pengesa të mëdha nga pushteti komunist maqedonas.

Ata në çdo aspekt mundoheshin që të pengojn hapjen e paraleleve në gjuhën shqipe me arsytetime banale se mungon kuadri arsimorë duke i punësuar mësimëdhënësi tmaqedonas të ligjerojnë te kparalelja me mësim në gjuhën shqipe, të cilët ishin me mission nga pushteti që të shkatërrojnë paralelën e vetme me mësim në gjuhën shqipe. Kështue dhe ndodhi, kjo vërtetohet me faktin se në vitin shkollor 1964/65, u pranua paralelja e parë me nëxënës shqiptarë ku u regjistruan 41 nxënës të gjithë meshkuj e asnjë femër prej të cilëve mësimin e filluan 38 nxënës. Mirëpo për pushtetin sllavo-komunist maqedonas e sidomos atij të organeve udhëheqëse të gjimnazit „GoceDellçev” të Kumanovës, kjo paralele e formuar me mësim në gjuhën shqipe ishte there në sy.

²⁷⁹ Младен Митев, Средните училишта и ученички домови во Република Македонија, Скопје, 1996, стр. 43.

Ata u përgatitën gjatë tërë vitit duke planifikuar se si ta eliminojnë nga procesi këtë paralele shqipe. Planin, drejtorja e shkollës në krye me Lubica Kocevskën, e realizoi përmes dy profesorëve maqedonas, atë të lëndës së gjuhës maqedonase që e ligjeronte prof. Mira Maneva dhe të gjuhës latine që e ligjeronte prof. Boris Avramovski. Sipas evidencës pedagogjike pranë gjimnazit „Goce Dellçev” të Kumanovës në librin amë janë të evidentuar në fund të vitit 38 nxënës nga të cilët 14 nxënës e kaluan vitin e parë, ndërsa 9 nxënës e përsëritën vitin dhe 15 nxënës u udhëzuan në riprovim tek dy lëndët e potencuara dhe të gjithë ranë nga provimi duke u rumbullaksu numri në 24 nxënës që e përsëritën vitin e parë.

Sipas ligjit për arsim të mesëm, paralelja mund të formohej me mbi 15 nxënës, ndërsa në këtë paralele klasën e kaluan vetëm 14 nxënës dhe kjo paralele nuk vazhdoi në vitin e dytë. Kështu që nxënësit që e kaluan vitin e parë 14 nxënësit shqiptarë u shpërndanë 8 paralelet me mësim në gjuhën maqedonase edhe e vazhduan mësimin në vitin e dytë. Gjenerata e parë me mësim në gjuhën shqipe pranë gjimnazit të Kumanovës nuk e pati fatin të hyjë në analet e histories si avangarde e këtij gjimnazi. Mirëpo në vitin shkollor 1965/66 përsëri u hap konkursi për një paralele me mësim në gjuhën shqipe në gjimnazin „Goce Dellçev,” të Kumanovës. Përsëri edhe në këtë vitë shkollor ishin paraparë 9 paralele, 8 të rezervuar për nxënësit maqedonas dhe një paralele për nxënësit shqiptarë.

Në vitin e parë konkuruan nxënës nga Kumanova dhe rrethina si dhe 24 nxënësit që e kishin humbur vitin paraprak dhe përsëri u regjistruan në vitin e parë në klasën I-1-11, gjithsej 44 nxënës nga të cilët 42 meshkuj dhe dy femra. Sipas evidencës pedagogjike të kësaj shkolle në librin amë, vitin e kaluan 31 nxënës, prej të cilëve 29 djem dhe 2 vajza, ndërsa vitin e përsëritën 8 nxënës, ndërsa 7 nxënës e kishin lëshuar mësimin gjatë vitit shkollor. Kjo paralele me mësim në gjuhën shqipe llogaritet si paralelja e parë me mësim në gjuhën shqipe pranë gjimnazit „Goce Dellçev,” të Kumanovës. Kjo gjeneratë sipas evidencës pedagogjike të gjimnazit të Kumanovës në vitin shkollor 1968/69, arritën të mbarojnë e të dalin gjenerata e parë e maturantëve pranë këtij gjimnazi.

Sipas rrefimit të nxënësit të klasës IV-5, të paralelës së parë të normalistëve, Elmi Rexhepi, i cili kujton atë kohë kur në vitë të parë u regjistruam 46 nxënës, por në vitin e katërt arritëm të mbarojmë mature vetëm 19 nxënës, ngatë cilët 17 djem dhe dy vajza, dhe dy e përsëritën vitin e katërt.²⁸⁰ Në vitin shkollor 1974/75, me rastin e 20-vjetorit të themelimit të Gjimnazit “Goce Dellçev” të Kumanovës, krahës rritjes së paraleleve me mësim në gjuhën shqipe u rrit edhe numri i mësimëdhënësve ku nga numri i përgjithshëm me 78 mësimëdhënës, 64 ishin mësimëdhënës maqedonas dhe 14 mësimëdhënës shqiptarë. Mirëpo vitet kalonin e situatë shkonte drejt keqësimit dhe mirrte kahje të një politike anti-shqiptare të cilës i paraprinte në fillim K.Q i LKJ-së, me mbështetje të plotë nga R.S e Maqedonisë.

Beogradi zyrtar, ia filloi fushatës së vetë, ku sulmi i parë ishte ndaj institucioneve shkollore, kuadrit arsimor dhe nxënësve. Me organizimin e demonstrative në vitin 1981 në Kosovë dhe në shumë vende tjera ku jetonin shqiptarët, gjendja për një here ndryshoi në gjimnazin „Goce Dellçev” të Kumanovës. Filluan të ndryshohen plan-programet mësimore në lëndët e gjuhës dhe letërsisë shqipe, historisë, gjeografisë, kultures muzikore e lëndëve tjera, ndërsa administratë pedagogjike filloi të udhëhiqet vetëm në gjuhën maqedonase.

Profesorët shqiptarë të asaj kohe filluan ta ngritin zërin e të mos pajtohen me masat restriktive që i merrnin kundër popullit shqiptarë. Më 13.11.1981, drejtori i gjimnazit Vllado Filipovski e caktoi një mbledhje në formë koligjiumi. Përpos profesorëve shqiptarë, në të do të marrin pjesë edhe përfaqësuesit politikë të Komunës së Kumanovës dhe funksionarët e lartë republikanë nga radhët e kombësisë shqiptare.

²⁸⁰ E dhënë gojore e Elmi Rexhepit (i lindur 20.7.1947), dhënë autorit më 4.11.2023, Kumanovë.

Qëllimi i mbledhjes nuk kishte të bënte vetëm me arsyetimin e zbatimit të nenit 102 të Ligjit për arsimin e mesëm dhe me udhëzimet e Sekretarit për Arsim dhe Shkencë për evidence pedagogjike në gjimnazin e Kumanovës, por me të do të nisët procesi i diferencimit ideo-politik, me ndihmën e përfaqësuesve politikë nga radhët e kombësisë shqiptare. Ata të cilët e kundërshtonin këtë rregullore pranuan vendimet për përjashtimin nga OBPB-ja (Organizata Bazë e Punës së Bashkuar) e „GoceDellçevit,“ të Kumanovës që mbante datën 20.11.1981. Kështu, vendime për largim nga puna morën profesorët: Avni Dehari, Esat Dehari, Naim Ibrahimi dhe Hisni Shaqiri, të cilët edhe u dënuan për veprime kundërvajtëse penale, që merrnin dënime prej 60 ditë gjerë në pesë vite heqje lirie. Për t’ju shmangur ndjekjeve policore dhe gjyqësore, ata migruan në Zvicër: Avni Dehari, Esat Dehari, Naim Ibrahimi dhe Hisni Shaqiri.²⁸¹

Politika anti-shqiptare e filluar nga viti 1981, kulmin e arriti në vitin shkollorë 1985/86 e cila u vu në zbatim për mbylljen e paraleleve me mësim në gjuhën shqipe në të gjitha shkollat e mesme në Kumanovë. Në vitin shkollor 1985/86, Sekretariati për Arsim dhe Shkencë në Maqedoni, kinse në interes të shqiptarëve solli vendim që mësimi në shkollat e mesme të zhvillohej vetëm në gjuhën maqedonase. Paralelet me mësim në gjuhën shqipe që vepronin në kuadër të qendrave të mesme shkollore, duhej të transformoheshin si pas modelit të ashtuquajtura-paralele të kombinuara në procesin edukativo-arsimor në Maqedoni.

Projektin për ndërprerjen e arsimit të mesëm shqip dhe heqjen prej përdorimi të gjuhës shqipe në shkollat e mesme të Kumanovës, projekt i cili nuk u realizua në vitin shkollor 1985/86, mirëpo vazhdoi të realizohet në vitin shkollor 1987/88.²⁸² Sipas këtij modeli, paralelet e pastërta etnike shqiptare ishin shkaktarë i nacionalizmit dhe separatizmit shqiptar. Politika shtetërore, paralelet e pastra etnike me mësim në gjuhën shqipe i shpalli si gjenerator i nacionalizmit, irredentizmit dhe separatizmit shqiptar. Ky vendim i Sekretariatit për Arsim dhe Shkencë, menjëherë u kundërshtua dhe u bojkotua nga numri më i madh i profesorëve dhe nxënësve shqiptarë të shkollave të mesme në Kumanovë.

Kjo gologotë e shqiptarëve në arsimin e mesëm shqip në Kumanovë dhe në vendet tjera zgjati deri në vitin shkollor 1990/91. Gjatë kësaj periudhe me modelin e paraleleve të përziera me nxënës të kombësisë maqedonase ku kishte me nga 5 - 6 nxënës maqedonas e mbi 30 nxënës shqiptar në paralele, por ata ishin të detyruar ngaviti shkollor 1987/88, nxënësit shqiptarë të shkollave të mesme u detyruan mësimin ta vijonin vetëm në gjuhën maqedonase.²⁸³ Me fillimin e pluralizmit demokratik në Republikën e Maqedonisë në vitin shkollor 1991/92 u bë e mundur rihapja e paraleleve shqipe të gjimnazit “GoceDellçev” të Kumanovës, fillimisht me iniciativën e qytetarëve të mbështetura nga kolektivi i Shkollës Fillore “Vllazërimi” (e më vonë “Naim Frshëri”), të menaxhuara nga drejtori i shkollës fillore Etem Xheladini, të përkrahur në mënyrë unanime nga kolektivi i shkollës fillore.

Meqënëse pushteti i kohës nuk i mire priti këto paralele për gjashtë muaj ai i pagëzoi si “paralele të egra”. Por falë rezistencës së drejtorisë dhe profesorëve që e realizonin procesin edukativo-arsimor, pas gjashtë muajve pushteti u detyrua t’i legalizojë. Pas një viti këto tri paralele që filluan në shkollën fillore ata u transferuan në gjimnazin „GoceDellçev” të Kumanovës, aty ku e kishin edhe vendin. Është për t’u përshëndetur nga këmbëngulsia dhe vendosmëria e drejtorisë dhe e kolektivit të paraleleve shqipe pranë kësaj shkolle dhe ata arritën të barten në gjimnazin dhe atë në vitin e dytë në vitin shkollor 1992/93. Kjo ishte një histori e dhimbshme për rininë shqiptare të Kumanovës. Kur u mbyllën shkollat e mesme, shumë të rinj u shpërndanë nëpër qendra tjera shkollore, në Preshevë, Gjilan, Prishtinë etj. Por, falë këmbëngulësisë së aktivistit Etem Xheladini, prindërve dhe profesorëve, në vitin 1992 u arrit që në mënyrë jashtë institucionale të sistemohen 149 nxënës që u shpërndanë në tri paralele.

²⁸¹ Esat Dehari, Tërmete Politike (1981-2001), Prishtinë 2021, fq.51

²⁸² Nazmi Maliqi, Gjurmë Politike, Shkup, 2001, fq.16

²⁸³ Esat Dehari, Tërmete Politike (1981-2001), Prishtinë 2021, fq.102

Po ashtu u siguruan edhe 14 profesorët të përgatitur për secilën lëndë mësimore. Ata ishin: Gjuhë dhe letërsi shqipe - Feim Ramdani, gjuhë dhe letërsi maqedone- Abdylmexhid Osmani, gjuhë frenge- LimanAvdiu, gjuhë angleze - Hajrulla Kasumi(Preshevë), Matematikë - Agim Rushiti, Histori - Naim Ibrahim, Biologji - Xhabir Isufi, Kimi - Zeqirja Dauti, Fizikë - Hysen Rrahmani, Art figurative -Rexhai Iseni, Art muzikor- Enver Latifi, Edukatë fizike - Musa Jonuzi, Informatikë -Sadulla Jakupi. Në mesin e kolektivit të paraleleve të mesme sekretar ishte Arif Xheladini dhe personel teknik Sami Beluli. Është për t'u përsëritur edhe ish drejtori i Shkollës Filllore "Bajram Shabani", Abdylmexhid Osmani i cili ishte i vetmi që kishte të mbaruar fakultetin e gjuhës maqedone dhe ishte adekuat për të ligjeruar këtë lëndë, meqë profesorët maqedonas nuk merrej parasysh që të punonin aty.

Dhe këtu ishte edhe zgjidhja kryesore që nxënësit e këtyre paraleleve të mos i nënshtroheshin provimit klasor të lëndës së gjuhës maqedone, edhe pse shteti kërkonte alibi që këto paralele të mos i pranojë asnjëherë. Por duke u menaxhuar problem në të gjitha segmentet, nuk arriti pushteti të gjej zbrazëtira ligjor edhe u detyrua para fakteve të heshtë dhe t'i pranojë këto pralele shqipe të filluara në shkollën fillore „Vllazërimi” dhe të transferohen në gjimnazin „GoceDellçev” të Kumanovës. Emira e këtij angazhimi ishte edhe tek numri i madh i nxënësve dhe ata u detyruan që paralelet ti rrisin nga 3 paralele që ishin gati në vazhdimësi të rriten në katër dhe në vitin shkollor 1992/93, konkursi u hap për 4 paralele me mësim në gjuhën shqipep ranë gjimnazit „GoceDellçev” të Kumanovës.

Viti shkollor 1994/95, me rastin e jubileut gjysmë shekullor, 50-vjetorit të fillimit të mësimin në gjuhën maqedonase, në këtë gjimnaz, kuadri i përgjithshëm arsimor ishte i përfshirë 80 mësimdhënës, nga të cilët shqiptarë ishin gjithsej 26 profesorë. Në këtë vit shkollor jubilar drejtori Boris Tasevski, emëroi për here të parë në historinë e këtij gjimnazi ndihmës drejtor prof.IsaAsllanin. Pastaj një periudhë dihmësdrejtor u caktua prof.Tefik Jahiu, më pastaj një periudhë të shkurtur ndihmës drejtor u caktua prof.Qani Aliu, më pastaj prof.Agim Rushiti dhe në fund ishte prof. MusaAjeti.

E gjithë kjo periudhë ishte me shumë problem për arsimin e mesëm shqip- gjimnazin e Kumanovës, por vlen të potencohet edhe iniciativa për të ardh deri te ndarja dhe dislokimi i paraleleve me mësim në gjuhën shqipe. Hapi i parë ishte në vitin 1999, në kohën e ndihmës drejtorit prof. Musa Ajeti, që tabloja e maturës së nxënësve shqiptarë të bëhet ndaras nga tabloja me nxënësit maqedonas. Edhe pse pati pengesa nga drejtoresha e gjimnazit Sllavica Stankovska, por pasi ishte me pagesën e nxënësve dhe nuk ishte pjesë e programit mësimor dhe ishte me vullnetin e nxënësve, ajo nu karriti ta pengojë dhe doli tabloja e parë e pastër me nxënësit shqiptarë me shkrim vetëm në gjuhën shqipe, edhe pse në një retrospektiv nxënësit e gjeneratës së parë të gjimnazit ato të vitit 1964-1968,qysh atëherë e kishin pas tabllon e maturës me nxënësit shqiptarë dhe me shkrim vetëm në gjuhën shqipe.

Në vitin shkollor 1997/98, numri i paraleleve u rrit në 6, edhe pse interesimi për tu regjistruar në shkollën e mesme në gjimnazin e Kumanovës ishte imadh dhe kishte mjaftueshëm nxënës që dëshironin të regjistroheshin. Ministria e Arsimit dhe drejtoria nuk jepnin pëlqim për tu rrit numri i paraleleve me mësim në gjuhën shqipe dhe trendi i punës në gjimnazin „GoceDellçev,, të Kumanovës vazhdonte të punojë me 5 paralele me mësim në gjuhën shqipe dhe sikur punët filluan të marrin të mbarën. Popullata shqiptare e Kumanovës dhe stafi mësimdhënës i gjimnazit bënin përpjekje të vazhdueshme për rritjen e numrit të paraleleve me mësim në gjuhën shqipe por gjithmonë haste në veshë të shurdhur.

Situata e përgjithshme politike gjatë viteve 1998/1999, u keqësua edhe ma shumë në Republikën e Maqedonisë, e sidomos me fillimin e luftës së armatosur të UÇK-së në Kosovë. Në vitin shkollor 1999/2000, u themeluan edhe dy paralele të gjimnazit në fshatin Likovë, të cilët në mungesë të lokalit ata mësimin e filluan në katin e katërt të shkollës fillore „Dituria” në fshatin Likovë, dhe nxënësit e gjimnazit arritën të rrisin numrin e paraleleve në gjashtë gjatë këtij viti shkollor.

Situata e rëndë politike e Kosovës u bart edhe në Republikën e Maqedonisë me fillimin e konfliktit të armatosur mes forcave vullnetare të UÇK-re dhe forcave policoro-ushtarake maqedonase. Situata e krijuar si pasojë e konfliktit të armatosur, situatë ajo që përfshiu periudhën shkurt-shtator 2001. Mirëpo, situatë dominante politike e cila shkaktonte tensione ndër etnike dhe acarim marrëdhëniesh mes maqedonasve dhe shqiptarëve, sidomos vëhej në dukje në mjediset ku ishin të banuara me shumicë maqedonase. Një gjë e tillë ishte prezente edhe në lokalitetet ku ishin të lokuara shkollat e mesme, në të cilat mësonin edhe nxënës shqiptarë. Manifestimi i hapur dhe mjaft i rrezikshëm i nacionalizmit dhe shovinizmit maqedonas paraqiste rrezik potencial për sigurinë e nxënësve maqedonas, gjë që manifestohej me incidente të vazhdueshme, rrahje, sulme tinzare, përbuzje dhe ofendime.

Situata kulminoi kur nxënësit maqedonas, të përkrahur nga vetë profesorët maqedonas dhe nga faktori politik maqedonas në ekzekutimin komunal dhe atë republikan, filluan protestat me kërkesë që nxënësit shqiptar të dislokohen nga qendrat e shkollave të mesme. E sidomos ishte e theksuar në Gjimnazin "GoceDellçev" në Kumanovë. Kjo situatë kishte edhe sakrificat e veta. Në një turbullirë të tillë edhe profesorët shqiptarë nuk u kursyen nga ofendimet, kërcnimet dhe madje edhe sulmet fizike. Kështu, në një përpjekje për të ndarë nga përlëshja fizike në mestë nxënësve shqiptarë dhe maqedonas, të cilët ishin tubuar para gjimnazit "GoceDellçev" në Kumanovë, nga një grup huliganësh maqedonas, të ndihmuar edhe nga shërbimi administrativ me përkatësi maqedone të punësuar në gjimnaz, u sulmua fizikisht, në mënyrë tinzare, edhe professori i matematikës, Agim Rushiti, të cilit iu shkaktuan edhe lëndim trupor dhe u deshtë të kërkoj edhe ndihmë në spital.

Kjo ndodhi krijoi një reagim gjithë popullor, sidomos të popullatës shqiptare të Kumanovës dhe Likovës, duke pasur parasysh se bëhej fjalë për një profesor meritore dhe njëndërn ishtarët për hapjen e paraleleve shqipe "të egra" në Kumanovë. Asaj kohe, faktori shqiptarë në ekzekutiv dhe ai jashtë asaj, nuk arritën të ofrojnë dhe gjejnë ndonjë zgjidhje konkrete me koalicionin qeverisës maqedonas dhe zgjidhja e vetme ishte që, me organizim vetanik, të drejtuar nga Këshilli i prindërve, të gjendet një zgjidhje e përkohshme për vijimin e vitit shkollor të nxënësve shqiptar. Kështu, nxënësit shqiptarë dhe stafi arsimor u larguan me dhunë nga objekti i gjimnazit, „GoceDellçev,“ i Kumanovës. Stafi arsimor bashkë me nxënësit shqiptarë në shtator vendosën që të dalin në rrugë për të kërkuar zgjidhje për ta.

Stafi arsimor maqedonas në këtë shkollë në shtator të vitit 2001/2002 e filluan vitin shkollor pa nxënësit e profesorët shqiptarë duke e realizuar ëndrrën e tyre të kenë paralele dhe shkollë të pastër vetëm me nxënës maqedonas e serb pa shqiptarët. Kuadri arsimor shqiptar duke mbetur pa rrugëdalje atëher të vetmën rrugë e gjetën për ta filluar vitin shkollor 2001/2002, në lokalet e shkollës fillore „Bajram Shabani“ në Kumanovë në ndërrimin e tretë me orar të shkurtuar, përshkak se shkolla fillore kishte numër të madh të nxënësve dhe nuk kishte hapësirë për t'i përfshirë edhe 6 paralelet shqipe të gjimnazit. Prindërit, profesorët dhe nxënësit maqedonas inskenonin lloje të ndryshme të sulmemeve ndaj nxënësve shqiptar me të vetmin qëllim që ato të mos kthehen në objektin e shkollës.

Me mbarimin e konfliktit të armatosur në Republikën e Maqedonisë dhe me nënshkrimin e Marrveshjes kornizë të Ohrit, gjendja e arsimit filloi të përmirësohet. Në vitin shkollor 2002/2003, paralelet e ndara me mësim në gjuhën shqipe të gjimnazit „GoceDellçev“ të Kumanovës fillimin e vitit shkollor e filluan në shkollën fillore „NaimFrashëri,“ dhe pas një kohe u transferuan në objektin e shkollës “ProfesorMihajllkoviç” në Kumanovë. Pas përpjekjeve të faktorit politik shqiptar u arrit një kompromis dhe u gjetë një zgjidhje jo e favorshme për nxënësit e gjimnazit që të transferohen në objektin e ashtuqujtur „ZIK“, i cili i shte objekt i Kombinatit Bujqësor dhe me adaptimin dhe renovimin pak sa mori formën e një shkolle të mesme ku nxënësit e gjimnazit, „GoceDellçev,“ paralelet e ndara vitin shkollor 2003/2004 e filluan në këtë objekt ku edhe sot ende janë aty.

Me kalimin në objektin e adaptuar të „ZIK” –ut stafi arsimor u kompletua dhe nxënësit shqiptar filluan ta gjejnë vetën më të sigurt se edhe objekti gjindej në një pjesë ku ishte me shumicë shqiptare. Në vitin shkollor 2003/2004, paralelet e ndara të gjimnazit, „Goce Dellçev” të Kumanovës në objektin e ish-Kombinatit Bujqsor, udhëheqëshin nga ndihmës drejtori prof. Nasuf Ukaj. Në vitin shkollor 2004/2005, punën e filluan me 4 paralele në qytet dhe dy paralele në fshatin Likovë, pra gjithsej me 6 paralele, dhe ndihmës drejtor për katër vite i udhëhoqi prof. Afrim Qerimi. Në vitin shkollor 2009/2010, ndihmës drejtorë ishin prof. Sami Latifidhe prof. Hysen Rrahmani, ndërsa si përgjegjës i dy paraleleve në fshatin Likovë ishte caktuar prof. Avdi Aliu.

E gjithë kjo golgotë e mësimit të mesëm të gjimnazit të Kumanovës me nxënësit shqiptar sikur i erdhi fundi i mire dhe në vitin shkollor 2010/2011, shkolla e mesme gjimnazi i ri u themelua me emrin „Sami Frashëri”, në të njejtin object (ish- ZIK-u) si shkollë e mesme e pavarur. Po ashtu në të njejtin vit shkollor 2010/2011, edhe paralelet e ndara të gjimnazit në fshatin Likovë kaluan në themelimin e një shkolle të mesme komunale me emrin e ri të heroit të Luftës Çlirimtare të Kosovës “Ismet Jashari”. Kështu viti shkollor 2010/2011, ishte vit i sukseseve të shqiptarëve duke filluar këtë vit me dy shkolla të mesme të pavarura dhe me dy drejtorë të ri. Drejtor i parë i shkollës së mesme gjimnazi „Sami Frashëri” u zgjodh prof. Hysen Rrahmani dhe ndihmës i tij prof. Minir Ademi. Në shkollën e mesme komunale „Ismet Jashari” në fshatin Likovë drejtor i parë i kësaj shkolle u zgjodh prof. Avdi Aliu.

Me pavarësimin e gjimnazit „Sami Frashëri” në vitin shkollor 2010/2011, numri i paraleleve u rrit nga 6 në 8 paralele dhe drejtori Hysen Rrahmani në vitin shkollor 2011/2012, për ndihmës të tij e caktoi prof. Abdulla Muhadinin dhe prof. Afrim Alitin. Shkolla e mesme komunale „Ismet Jashari”, vitin shkollor e filloi me rritjen e paraleleve nga dy në katër paralele. Nga ky vit i sukseshëm i gjimnazistëve numri i paraleleve në këto dy shkolla të mesme u rrit në 12 paralele me gjithsej 1300 nxënës. Shkolla kishte të gjitha organet udhëheqëse me sekretarin Halil Kamberi, pedagogun Sabit Kurteshi dhe psikologën Ibadete Rushiti-Ramadani. Shkolla e mesme gjimnazi „Sami Frashëri”, pati mjaft suksese si në gara republikane edhe ato regjionale në shumë lëndë mësimore. Këtë gjimnaz në dy mandate e udhëhoqi prof. Hysen Rrahmani. Në vitin shkollor 2019/2020 drejtoriri u zgjodh prof. Afrim Aliti, ndërsa ndihmës të tij caktoi prof. Abdulla Muhadinin dhe prof. Hysen Rrahmanin.

Në vitin shkollor 2021/2022, filloi dukshëm të bjerë numri i nxënësve dhe nga paraqitja e numërit të nxënësve për tu regjistruar në gjimnazin „Sami Frashëri” u zvoglua dhe Ministria e Arsimit në këtë vit shkollor zvogloi numrin e paraleleve nga 8 në 7 paralele. Në vitin shkollor 2023/2024, drejtor i gjimnazit „Sami Frashëri” u zgjodh prof. Nagri Rexhepi, dhe nga shkurti i vitit 2024 dy ndihmës të tij prof. Mirushe Bislimi-Destani dhe prof. Ardian Jashari, ku duhet të potencohet që përherë të parë në këtë gjimnaz u zgjodh dihmës drejtoreshë nga gjinia femërore. Sipas të dhënave nga stafi pedagogjik, nga themelimi i gjimnazit „Sami Frashëri” në fillim kishte 9 paralele e mëvonë u zvogluanë 8, përfshirë në për klasa mbi 34 nxënës, dhe gjithsej numri i nxënësve në këtë shkollë kishte arritur në 1370 gjatë viteve 2012/2013.

Stafi arsimor arrinte numrin atëherë në 70, prej të cilëve 60 ishin mësime të ndihmës dhe 10 punëtorë teknik. Në vitin shkollor 2023/2024, numri i nxënësve nëpër paralele dukshëm është zvogluar dhe në këto 29 paralele të ndarë në 4 vite numri i përgjithshëm i nxënësve arrin në 595 të rregullt dhe dy nxënës të çregullt gjithsej 597. Me këtë shihet se si për një periudhë 13-vjeçare numri i nxënësve në këtë shkollë është përgjysmuar. Në këtë vit shkollor 2023/2024 gjendja momentale e regjistrimit të nxënësve është si vijon: Në vitin e parë janë të regjistruar 7 paralele me gjithsej 134 nxënës prej të cilëve 78 meshkuj dhe 56 femra, në vitin e dytë në 7 paralele me 140 nxënës nga të cilët 66 meshkuj dhe 74 femra, në vitin e tretë në 7 paralele janë të regjistruar 156 nxënës prej të cilëve 77 meshkuj dhe 79 femra dhe në vitin e katërt në 8 paralele janë të regjistruar 165 nxënës nga të cilët 71 meshkuj dhe 94 femra.

Pra nga gjithsejt 595 nxënës që ndjekin mësimet në gjimnazin “Sami Frashëri” të Kumanovës, 292 janë meshkuj dhe 303 femra.

Referencat

- [1]. Ademi Minir, *Arsimi shqip në Kumanovë e rrethinë (1945-1995)*, Kumanovë, 2012
- [2]. Maliqi Nazmi, *Gjurmë politike*, NADC, Shkup, 2001
- [3]. Поповски Стојан, *Првите училишта на мајчин јазик во Куманово и Кумановско*, Куманово, 2004
- [4]. Rushiti Agim, *Me pishtarët e arsimit shqip në komunën e Kumanovës e të Likovës (1945-1960)*, Kumanovë, 2006
- [6]. Xheladini Etem, *Lufta jonë për arsimin shqip*, Kumanovë, 2016